

**LICENCË**  
**PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT ENERGJETIK**  
**PËRÇIMI I GAZIT NATYROR**

**1. Emri dhe selia e Shoqërisë aksionare të licencuar**

Shoqëria Aksionare për ushtrimin e veprimtarisë energjetike përcimi i gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, Акционерско друштво за вршење на енергетска дејност пренос на природен гас НОМАГАС Скопје во државна сопственост, Joint Stock Company for performing energy activity natural gas transmission NOMAGAS Skopje in State Ownership, BULEVARDI "SHËN KLIMENT OHRIDSKI" Nr.54 SHKUP-QENDËR, QENDËR

**2. Veprimtaria energjetike për të cilën lëshohet licenca**

Përcimi i gazit natyrorë

**3. Data e lëshimit të licencës:** 25 Tetorë 2005

**4. Data e vlefshmërisë së licencës:** 25 tetor 2040

**5. Numri i evidentuar i licencës së lëshuar:** PG-TSO-02-2005 (ПГ-ОПС-02-2005)

**6. Numri i identifikimit:** 7649401

**7. Numri tatimor:** 4080022611460

**8. Zona në të cilën ushtrohet veprimtaria energjetike**

Bartësi i licencës ushtron veprimtarinë energjetike të përcimit të gazit natyrorë përmes sistemit të përcimit dhe menaxhimit të sistemit të përcimit të gazit natyror, në territorin e Maqedonisë së Veriut.

**9. Objektet dhe pajisjet me të cilat kryhet veprimtaria energjetike**

Bartësi i licencës ushtron veprimtarinë e përcimit të gazit natyrorë, nëpërmjet rrjetit të përcimit që përbëhet nga:

- gazsjellës me presion të lartë nga kufiri Maqedoni-Bullgari në Deve Bair deri në Shkup, si dhe degë të gazsjellësit me presionit të lartë nga gazsjellësi magjistral deri te stacionet kryesore matëse-rregulluese të vendosura në Kriva Pallank, Kratovë, Kumanovë, Shkupi-Veri dhe Shkup-Jug;

- stacioni kryesor pranues-transmetues në hyrje të Republikës së Maqedonisë së Veriut në afërsi të fshatit Zhidilovo në kufirin maqedono-bullgar;

- stacionet kryesore matëse-rregulluese në Kriva Palankë, Kratovë, Kumanovë, Shkup-Veri dhe Shkup-Jug;

- rrjetet e përcimit të gazit në qytetet Kriva Palanka, Kratovë, Kumanovë dhe Shkup;

- stacionet e matjes dhe rregullimit të bashkangjitura me sistemin e përcimit të gazit natyror të destinuar për konsumatorët e drejtpërdrejtë dhe sistemet e shpërndarjes.

## 10. Detyrimet e përgjithshme për bartësin e licencës

Bartësi i licencës është i detyruar:

- për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe zgjerimin e rrjetit të përçimit të gazit natyror, të administron sistemin e përçimit të gazit natyror dhe të mundëson ndërlidhje me sisteme të tjera duke përfshirë sistemet e përçimit të gazit natyror të vendeve të tjera;
- të kontribuojë për sigurinë e furnizimit me gaz natyror, duke mundësuar përçim dhe shpërndarje të besueshme, të sigurt, ekonomikisht të qëndrueshme dhe cilësore të gazit natyror përmes sistemit të e përçimit;
- të mundëson funksionimin e besueshëm dhe të sigurt të sistemit të përçimit të gazit natyror dhe avancimin e operacionalitetit;
- në çdo kohë të ketë në dispozicion burimet materiale, teknike dhe njerëzore si dhe mjetet financiare të nevojshme për të përmbushur detyrimet e tij lidhur me zhvillimin, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të përçimit të gazit natyror;
- t'u mundëson atyre të gjithë informacionet e nevojshme për qasjen dhe përdorimin e sistemit të përçimit të gazit natyror dhe t'u sigurojë qasje përdoruesve të sistemit të përçimit të gazit natyror;
- të miratojë kërkesat e përdoruesve për kyçe në sistemin e përçimit në përputhje me rregullat e rrjetit për përçimin e gazit natyror, nëse është e justifikuar ekonomikisht,
- të publikojë në faqen e saj të internetit tarifat e përçimit, të miratuara më parë nga Komisioni Rregullator i Energjisë;
- të ndërtojë ndërlidhje të reja dhe ti avancojë kapacitetet ekzistuese me vendet fqinje, duke marrë parasysh përdorimin efikas të kapaciteteve ekzistuese të interkoneksionit dhe balancën mes kostove të investimit dhe përfitimeve për konsumatorët;
- të mundësojë përçimin ndërkufitar të gazit natyror përmes rrjetit të saj të përçimit brenda kapacitetit të disponueshëm të përçimit;
- të zhvillojë plan vjetor për mirëmbajtjen e sistemit të përçimit dhe pas miratimit të tij nga Komisioni Rregullator i Energjisë, ta publikojë në ueb faqe;
- të zhvillojë orar përfundimtar ditor për përçimin dhe ngarkesën e sistemit të përçimit të gazit natyror dhe të regjistrojë dhe ruan të dhënat e përfuara në procesin e përgatitjes së orarit përfundimtar ditor;
- të mundëson dispeçimin ditor dhe administrim në kohë reale të fluksit të gazit natyror duke marrë parasysh transaksionet e brendshme dhe ndërkufitare nëpërmjet sistemit të përçimit të gazit natyror, bazuar në orarin përfundimtar ditor;
- të mundëson funksionimin e sinkronizuar të sistemit të përçimit të gazit natyror me sistemet e përçimit me të cilat është i lidhur drejtpërdrejt, si dhe të bashkëpunojë dhe shkëmbejë të dhëna me operatorët e sistemeve të tjera të përçimit të gazit natyror;

- të publikojë të dhëna dhe të mundëson informacion në kohën e duhur nga operatorët e sistemeve fqinje të përçimit të gazit natyror për kapacitetet e disponueshme në tubacionet e interkonektorëve ose gazsjellësve transnacional, në mënyrë që të mundësojë qasje dhe përdorim efikas, jodiskriminues, objektiv dhe transparent të sistemit të përçimit të gazit natyror.
- të mundësojë instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve matëse dhe të masë rrjedhjen e gazit natyror në të gjitha pikat matëse, në pikat e pritjes dhe të dërgimit të sistemit të përçimit dhe për të dhënë të dhënat e matjes tek përdoruesit e sistemit dhe tek operatori i tregut të gazit natyrorë;
- t'u mundësojë përdoruesve të sistemit të përçimit të gazit natyror qasje në pajisjet matëse që disponon;
- të prokurojë shërbime të sistemit për balancimin e sistemit të përçimit të gazit natyror, në përputhje me rregullat për balancim të sistemit të përçimit të gazit natyror;
- të krijojë dhe mbajë një regjistër të ofruesve të shërbimeve balancuese dhe regjistër të palëve përgjegjëse balancuese;
- të hartojë rregullat për prokurimin e gazit natyror për mbulimin e humbjeve në sistemin e përçimit të gazit natyror dhe t'ia dorëzojë për miratim Komisionit Rregullativ të Energjisë;
- të prokurojë gaz natyror për të mbuluar humbjet në sistemin e përçimit të gazit natyror në mënyrë që të mundësojë funksionim të sigurtë dhe të besueshëm të sistemit të përçimit të gazit natyror sipas kushteve të tregut në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe konkurruese;
- të zgjidhë mbingarkesat në rrjetin e përçimit të gazit natyror, në përputhje me rregullat e rrjetit për përçimin e gazit natyror;
- të sigurojë balancimin e sistemit të përçimit të gazit natyror dhe shlyerjen e devijimeve dhe shërbimeve të balancimit, në lidhje me ofruesit dhe përdoruesit e shërbimeve të balancimit, si dhe të sigurojë llogaritjen, faturimin dhe mbledhjen e shërbimeve të balancimit;
- të mbajë shënime dhe orare të transaksioneve fizike dhe të përcaktojë ndryshimet e nevojshme në orarin e dispeqimit të përçimit të gazit natyror në rast të një rrezikimi në furnizimin me gaz natyror, aksidenteve ose devijimeve të mëdha të konsumit të gazit natyror nga sasi të përcaktuara brenda mundësive teknike të sistemit të përçimit të gazit natyror, ku shpenzimet e blerjes së gazit natyror, duke aplikuar mekanizmin e balancës, kompensohen nga pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror që kanë shkaktuar devijimin;
- të mundësojë konfidencialitetin e të dhënave të biznesit të përdoruesve të sistemit të përçimit të gazit natyror;

- të marrë pjesë në punën e organizatave rajonale dhe ndërkombëtare, dhe në kohën e duhur të mundëson informacion për operatorët e sistemit të përçimit dhe operatorët e sistemit të distribuimit të gazit natyror me të cilët është i lidhur, me qëllim sigurimin dhe funksionimin efikas të sistemeve dhe linjave interkonektive;
- të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të gazit natyror, të gjitha pikat hyrëse dhe dalëse, kapacitetin e përgjithshëm të sistemit, duke pasur parasysh integritetin e sistemit dhe funksionimin efikas të rrjetit;
- të mbajë librin e dispeçimit, të dhënat për besueshmërinë e sistemit të përçimit, të dhënat nga sistemi i mbikëqyrjes dhe administrimit, të dhënat e matjes dhe t'i ruajë ato libra, regjistra dhe të dhëna për të paktën dhjetë vjet;
- të mbajë evidencë për funksionimin e sistemit të përçimit në mënyrën e përcaktuar me rregullat e rrjetit për përçimin e gazit natyror dhe këtë t'ia raportojë Komisionit Rregullator për Energji, me kërkesën e tij;
- të pezullojë përkohësisht furnizimin e gazit natyror nga rrjeti i përçimit që administron gjatë inspektimeve të planifikuara, testeve, matjeve kontrolluese, riparimeve, mirëmbajtjes, rikonstruksioneve dhe zgjerimeve të objekteve, pajisjeve dhe instalimeve, lidhjes së përdoruesve të rinj, si dhe në rast të nevojave për të parandaluar rreziqe nga çrregullime në sistemin e përçimit të gazit natyror, në përputhje me rregullat e rrjetit për përçimin e gazit natyror;
- çdo vit të përgatisë planin për zhvillimin e sistemit të përçimit të gazit natyror për një periudhë dhjetëvjeçare dhe të dorëzojë planin për miratim në Komisionin Rregullativ për Energji jo më vonë se 31 tetori i vitit kalendarik dhe pas marrjes së miratimit plani të miratohet dhe të publikohet në faqen e tij të internetit;
- përgatit dhe më së voni deri më 31 tetor të vitit kalendarik parashtron deri tek Ministria dhe Komisioni Rregullativ për Energjetikë parashikime njëvjeçare, pesëvjeçare dhe dhjetëvjeçare për kërkesën për gaz natyror në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- për çdo periudhë të rregulluar përgatit dhe i paraqet për miratim në Komisionit Rregullativ për Energji planet për investime në sistemin e përçimit, të cilat duhet të tregojnë veçanërisht rritjen e pritur të efikasitetit të punës së sistemit si rezultat i investimeve të planifikuara;
- të ofrojë shërbime të aksesit të përhershëm ose të ndërprerë për një palë të tretë dhe të mundësojë që çmimi për kapacitetin që i nënshtrohet ndërprerjeve pasqyron probabilitetin e ndërprerjeve;
- t'u ofrojë përdoruesve të sistemit shërbime afatgjata dhe afatshkurtra;
- të ofrojë shërbime të përçimit të gazit natyror për përdoruesit e sistemit duke zbatuar kushte të barabarta kontraktuale, të miratuara më parë nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe të publikuara në faqen e tij të internetit;

- të miratojë qasjen e palëve të treta nëse kërkuesi i qasjes ofron garanci për pagesën e shërbimit, të cilat përcaktohen në bazë të parimeve të mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit dhe nuk paraqesin pengesë për hyrjen në tregun e gazit natyror.

## **11. Detyrimi për të dorëzuar një raport vjetor të punës**

**Bartësi i licencës është i obliguar t'i dorëzojë Komisionit Rregullator për Energji dhe Shërbime të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më së voni deri më 31 mars të vitit aktual, Raport vjetor për operimin, duke përfshirë raportin për veprimtarinë financiare dhe afariste në vitin e kaluar.**

Raporti vjetor me të gjitha bashkëngjitjet duhet të dorëzohet edhe në formë elektronike.

Raporti vjetor duhet të përmbajë të dhëna për:

1) përshkrimin dhe shtrirjen e aktivitetit energjetik gjatë vitit,

2) llogaria përfundimtare vjetore me të gjitha bashkëngjitjet,

3) masat e marra gjatë vitit raportues për:

- mbrojtja e objekteve dhe pajisjeve nga ndikimet e jashtme dhe aksidentet dhe siguracioni i objekteve dhe pajisjeve për kryerjen e veprimtarive energjetike;

- sigurinë dhe shëndeti në punë

- plotësimi i personelit, trajnimi dhe zhvillimi profesional i punonjësve

- Mbrojtja e mjedisit, jetës dhe shëndetit të njerëzve,

- performanca e monitorimit të operimit,

- kryerja e veprimtarisë në kushtet e krizës, ndryshimit të kushteve të tregut botëror, si dhe gjendjes ushtarake dhe të jashtëzakonshme;

4) realizimi i programit vjetor të riparimit,

5) zbatimi i planit të punës që i referohet vitit përkatës;

6) inspektime, monitorime dhe kontrole të kryera nga inspektorë dhe autoritetet e tjera shtetërore kompetente, të bashkëngjitura fotokopjet e procesverbaleve, raporteve dhe vendimeve nga inspektimet, mbikqyrjet dhe kontrollet e kryera,

## **12. Konfidencialiteti i informacionit**

**Bartësi i licencës** është i detyruar, në përputhje me ligjin, të sigurojë dhe të garantojë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacioneve të biznesit gjatë kryerjes së veprimtarisë energjetike të përçimit të gazit natyror.

## **13. Sigurimi i lidhjes dhe përdorimit të sistemit të përçimit**

Bartësi i licencës është i detyruar të sigurojë lidhjen e të gjithë konsumatorëve të gazit natyror ose të energjisë termike dhe të gjithë përdoruesve të sistemit të përçimit të gazit natyror dhe sistemeve të shpërndarjes së gazit natyror ose energjisë termike, si dhe qasjen e palëve të treta në përdorimin e sistemit të përçimit në përputhje me ligjin, rregulloren tjetër dhe aktin e përgjithshëm, si dhe në bazë të Rregullave të rrjetit për përçimin e gazit natyror, të miratuara nga Komisioni Rregullator i Energjisë, bazuar në parime objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

## **14. Cilësia e shërbimit**

Bartësi i licencës është i detyruar të sigurojë nivelin e nevojshëm të konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së sistemit të përçimit si kusht për cilësinë e gazit natyror të dorëzuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara të përçimit dhe dorëzimit të gazit natyror dhe rregullat e rrjetit

## **15. Ndryshimi, zgjatja, bartja, ndërprerja, pezullimi dhe tërheqja e Licencës**

Ndryshimi, vazhdimi, bartja, përfundimi, pezullimi dhe tërheqja e kësaj licence do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Energjetikë dhe Rregullores për Licenca.

## **16. Masat në rast të mosrespektimit të detyrimeve të të licencuarit**

Nëse bartësi i licencës nuk i përmbush obligimet e përcaktuara në këtë licencë, Komisioni Rregullatorë për Energji dhe Shërbime të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të ndërmarrë masa në pajtim me Ligjin për Energji dhe Rregulloren për Licenca.